



Datë: 26.09.2025
Numër Protokolli: 6363/2025

A.nr.816/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.816/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesja L.B, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Enis Dema nga Kaçaniku, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të LPPA-së, në seancën për këshillim dhe votim të datës 26.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.816/2025, e datë 05.05.2025, e parashtruar nga ankuesja L.B.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër reference DS-171/2025, i datës 26.03.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja L.B (*tutje referuar ankuesja*), më datë 28.04.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 05.05.2025, kundër Vendimit me numër reference DS-171/2025, të datës 26.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe aplikimit jo të drejtë të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*tutje referuar SKGJK*), ndërsa, ky i fundit më datë 02.07.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2957/2025, të parashtruar nga ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar më datë 28.04.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër reference DS-171/2025, i datës 26.03.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Plikon e datës 01.04.2025; Vendimin KGJK:nr.01/2023 të datës 18.01.2023; Kërkesën për pagesën e diferencës në pagë; Akt emërimit me referencë: DS-678/2024 të datës 01.07.2024; Akt emërimit me Nr.ref.280/2018 të datës 07.06.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Autorizimin e datës 06.03.2025; Formularin e parashtrimit të ankesës së datës 05.05.2025; Pliko e datës 28.04.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Listën e pagave për muajin Janar 2023; Listën e pagave për muajin Shkurt 2023; Listën e pagave për muajin Maj 2023; Listën e pagave për muajin Korrik 2023; Listën e pagave për muajin Tetot 2023; Listën e pagave për muajin Dhjetor 2023; Listën e pagave për muajin Janar 2024; Listën e pagave për muajin Mars 2024; Rregulloren Nr.02/2024, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil të Administratës së Sistemit Gjyqësor; Vendimin e datës 17.06.2025 të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja fillimisht sipas Akt Emërimit me numër protokolli 280/18, të datës 07.06.2018, ka themeluar marrëdhënie punës në pozitën *Asistent Administrativ 3* në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik, me koeficient të pagës 6 (sistemi i vjetër i pagave), ndërsa, pas miratimit të Rregullores Nr. 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civile në Administratën e Sistemit Gjyqësor, i është lëshuar akt emërimi me numër Reference DS-678/2024 i datës 01.07.2024 për pozitën Sekretare Juridike, në Gjykatën Themelore Ferizaj, Dega Kaçanik, klasa profesional 2, Klasa e pagës J16, koeficienti 5.3.

Ankuesja përmes përfaqësuesit të tij më autorizim, më datë 11.03.2025, i është drejtuar më kërkesës SKGJK-së për kompensim të diferencës së pagës nga klasa profesional 3 në klasën profesional 2 dhe atë në mënyrë retroaktive nga muaji korrik 2023 deri në qershor 2024. Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, më Vendimin ref: DS-171/2025, të datës 26.03.2025, ka refuzuar kërkesën e ankueses, me arsyetimin se SKGJK-ja ka vepruar në pajtim më Vendimin Nr.04/128, të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me referencës DS-171/2025, të datës 26.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së të pranuar më datë 01.04.2025, duke pretenduar së akti i kundërshtuar me ankesë edhe nxjerr si rezultat i vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit jo të drejtë të së drejtës materiale, ngase Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datës 18.01.2023 ka nxjerr vendim për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuar në gjyqësor ku pozita Sekretar Juridik është klasifikuar në klasën profesional 2, grupi J, klasa J16, koeficienti 5.30, ndërsa ky vendim nuk është zbatuar edhe përkundër faktit që nuk ka pasur ndonjë akt që e pezullon zbatimin e këtij vendimi dhe ky vendim nuk është zbatuar deri në qershor të vitit 2024. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet akti i kundërshtuar me ankesë dhe të bëhet kompensimi i diferencës së pagës nga klasa profesional 3 nga koeficienti 4.3 në klasën profesional 2 në koeficientin 5.3 nga muaji shkurt 2023 deri në muajin qershor 2024.

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazushmerisë së pretendimeve ankimore, ri kujton fillimisht faktin e pa kontestuar së Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 22.12.2022 ka miratuar Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (i zbatueshëm nga data 05.02.2023), ndërsa, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 18.01.2023, ka nxjerrë Vendimin KGJK. nr.01/2023, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Gjyqësor, ku përmes pikës III, hyrja në fuqi e këtij vendimi është kushtëzuar me hyrjen në fuqi të Ligjit /L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Ndërsa, më datë 06.06.2024 ka miratuar Rregulloren Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Rrjedhimisht, Ligji bazik Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me nenin 2, ka përcaktuar se: ''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë'', ndërsa, me nenin 14, paragrafi 3, ka paraparë së 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik... ''

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar së edhe pse KGJK kishte nxjerrë Vendimin GJK. nr.01/2023 të datës 18.01.2023, për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Gjyqësor, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, procedimi i pagave sipas sistemit të ri të pagave për të gjithë të punësuarit në SKGJK-ë është bërë sipas koeficienteve të miratuar më Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës (lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë), e si pasojë, ankuesja duke qenë se sipas Akt Emërimit me numër protokolli 280/2018, të datës 07.06.2018 ka pas koeficient 6 të pagës, atëherë, e njëjta ka realizuar pagë me koeficient 4.3. Pra, përkundër kësaj ankuesja ka realizuar koeficient ashtu siç përcaktohej me pikën 17.5 të Vendimit KGJK. nr.01/2023 të datës 18.01.2023, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sepse ankuesja në atë kohë ushtronte pozitën asistente administrative. Rrjedhimisht, si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës, nuk ka mundur të zbatohet Vendimi KGJK. nr.01/2023 i datës 18.01.2023, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sepse, sipas pikës 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës, ky vendim ishte e detyrueshëm për të gjitha institucionet publike deri në klasifikimin e pozitave të punës nga institucionet publike.

Bazuar në praktiken kushtetuese tashme të konsoliduar (aktgjykimet KO79/23, KO219/19, KO73/16, KO171/18, me KO203/19), institucionet e sistemit të drejtësisë kanë pavarësinë tyre të organizmit dhe të funksionimit, duke nënkuptuar të drejtën që më akt të veçantë të rregulloj organizmin dhe klasifikimin vendeve të punës për të punësuarit në këto institucione, atëherë, në reference të kësaj pavarësie Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 06.06.2024 ka miratuar Rregulloren Nr. 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ku pozita e ankueses ishte klasifikuar në Sekretare Juridike më klasë profesional 2, Grupi J, Klasa e pagës J116, koeficienti 5.3.

Nisur nga theksimet si më sipër, Kolegji vlerëson së nuk gjejnë mbështetje pretendimet ankimore të ankueses për kompensim të diferencës së koeficientit të pagës nga klasa profesional 3 më koeficienti 4.3, në klasën profesional 2, më koeficientin 5.30, dhe atë për periudhën shkurt 2023 deri qershor 2024, pasi që sikurse u tha më lartë, Vendimi KGJK. nr.01/2023 i datës 18.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nuk ka mundur të zbatohet për shkak të rrethanave juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, dhe se siç u tha me sipër ankuesja ushtron pozitën e sekretares juridike vetëm pas klasifikimit të pozitës së saj sipas Rregullores 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civile në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Thënë si më sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132, paragrafi 2 të LPPA-së, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.816/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Enis Dema;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.